



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Kryesues i KQZ-së

Prof. ass. dr. Arbnor Ajeti

Nr. Prot. 890 Dt 19.04.2023

ZGJEDHJET STUDENTORE 2023
NJOFTIM PUBLIK PËR STUDENTËT

Në pajtim me Rregulloren për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë, ju njoftojmë se me rastin e aplikimit OS paraqesin:

- Aplikacionin, të cilin mund ta shkarkoni në web faqen e UIBM – it në linkun Zgjedhjet 2023.
- Licencën e regjistrimit në Ministrinë e Administratës Publike.
- Statutin e OS.
- Formularin e deklaratave mbështetëse me nënshkrime. Formulari me të dhënat e studentëve që kanë mbështetur OS duhet të plotësohen edhe në formë elektronike në exell – Formularin mund ta shkarkoni nga web faqja e UIBM – it në linkun Zgjedhjet studentore 2023.
- Përcaktimi i të adresuarit të autorizuar të OS.

Në bazë të nenit 8 pika 3 të Rregullore për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve përcaktohet:

"Të gjitha organizatat studentore, të cilat janë regjistruar në mënyrë të rregullt si "shoqatë"- "asociacion" në Ministrinë e Administratës Publike sipas ligjit në fuqi konsiderohen të regjistruara, ndërsa për themelimin e organizatave të reja ato duhet të regjistrohen së paku 15 ditë para datës së zgjedhjeve".

Aplikimin për pjesëmarrje në zgjedhje OS mund ta bëni deri më 24.04.2023.

Ju njoftojmë, gjithashtu, se listat e kandidatëve, në pajtim me Rregulloren për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve, mund t'i dorëzoni deri më 02.05.2023. Formularin për paraqitjen e kandidatëve mund ta shkarkoni në web faqen e UIBM – it në linkun Zgjedhjet studentore 2023.

Sqarim shtesë lidhur me numrin e deklaratave mbështetëse për certifikim: OS që siguron së paku 150 nënshkrime të studentëve të UIBM, fiton të drejtën të radhitet në OS konkurrencte për zgjedhje studentore për Parlament të studenteve dhe Këshilla të studentëve të secilit nga fakultetet e UIBM. Për konkurrim vetëm në zgjedhjet për këshilla të studentëve në ndonjërin nga fakultetet, OS duhet të sigurojë së paku 50 nënshkrime të studentëve dhe të cilët janë studentë të po atij fakulteti.

Prof. ass. dr. Arbnor Ajeti

Kryesues i KQZ-së

